

**Nr. 2304/32 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 21/04/2023**

**Drejtuar:** Komisionit Qendror të Zgjedhjeve  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
z. Ilirjan CELIBASHI

**Lënda:** REKOMANDIME – Lidhur me  
projekt-vendimin “Për  
përcaktimin e sasisë së fondit nga  
buxheti i shtetit që do t’u  
shpërndahet si paradhënie partive  
pjesëmarrëse në zgjedhjet për  
organet e qeverisjes vendore, të  
datës 14 maj 2023”

**I Nderuar Z. Komisioner!**

**Të nderuar kolegë të administratës së KQZ-së!**

Në kuadër të gjithë bashkëpunimit me ju lidhur me konsultimin paraprak të projekt-akteve të ndryshme, për të cilin gjejmë rastin t’ju falenderojmë sërish, KRIIK ju paraqet shkurtimisht qëndrimin e tij lidhur me projekt-vendimin “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.

Sipas relacionit të dërguar të këtij projektvendimi, në faqen 3 të tij parashikohet se: “Neni 180 i Kodit Zgjedhor, “Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti”, përcakton se për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përlllogaritja e shpërndarjes së fondeve paradhënie do të bëhen në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

Duke qenë se zgjedhjet e para të përgjithshme për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, janë zgjedhjet e datës 14 maj 2023, përlllogaritja e numrit të votave të vlefshme bëhet duke marrë numrin më të lartë të votave për secilën parti politike që ka përfutuar mbi 1% të votave të vlefshme në njërën nga këto zgjedhje 2015, 2017 dhe 2019.”

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailing address:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

KRIIK ju parashtron se neni 180 i Kodit Zgjedhor “Dispozitë tranzitore për financimin nga buxheti” në pikën 2 të tij përcaton se: “Për secilën parti përfshihet në përlllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërën nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse.”

Partia Socialdemokrate (PSD), sipas tabelës së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve 2015, 2017 e 2019 të paraqitur në faqen 6 të relacionit, rezulton se në zgjedhjet e vitit 2015 ka marrë mbi 1 % të votave, e konkretisht ajo ka marrë 22 320 vota ose 1.43% të totalit të përgjithshëm të votave të vlefshme.

KQZ-ja në respekt të parashikimit të mësipërm duhet t'i referohet këtij numri votash në përllogaritjet që duhet të bëjë në vijim.

Konsiderimi i numrit prej 27 422 votash të marra prej PSD në zgjedhjet e vitit 2019 është i pasaktë, pasi sipas fjalisë së dytë të pikës 2 të nenit 180, merret në konsideratë rezultati i vitit 2019 vetëm në rastin kur subjekti zgjedhor nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2015 apo të vitit 2017.

Konkretisht, dispozita parashikon se “Në përllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre.”

Për rrjedhojë, duke saktësuar këtë shifër në përllogaritjet e bëra, rezulton se numri i përgjithshëm i votave të vlefshme të marra nga subjektet zgjedhore që kanë marrë më shumë se 1% të votave **është 1,743,583**, ndërsa **vlera në para e një vote rezulton të jetë 57.35316 lekë**, dhe jo 57.18583.

Lidhur me sa më sipër sugjerojmë që në tabelën e shpërndarjes së fondeve në projekt-vendim **vlera në para e një vote duhet të jetë 57.35316 lekë**, ndërsa numri i votave të vlefshme për subjektin zgjedhor **Partia Socialdemokrate (PSD) duhet të jetë 22 320 vota**.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto Gogo  
Kryetar**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailing address:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania